



Republika e Kosovës- Republika Kosova- Republic of Kosovo

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
Ministarstvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË
AGENCIJA ZA HRANU I VETERINARSTVO
FOOD AND VETERINARY AGENCY



AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË

RAPORTI VJETOR I PUNËS 2024

AGJENCIA E USHQIMIT DHE VETERINARISË

Janar, 2025

Fjala hyrëse

Viti 2024 shënoi vitin e parë të plotë timin në detyrën e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë. Që nga fillimi, pata mundësinë të udhëheq procesin e planifikimit të punës dhe të përcaktoj objektivat që synuam t'i realizonim brenda vitit kalendarik. Falë përvojës së fituar gjatë vitit paraprak, isha i vetëdijshëm se, pavarësisht planifikimit të kujdesshëm, gjithmonë do të ketë sfida dhe situata të paparashikuara.

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë është një institucion me mandat të gjerë, që mbulon fusha të ndërlikuara të kontrollit dhe mbikëqyrjes. Dinamika e sektorëve që mbulojmë sjell vazhdimisht zhvillime të reja dhe kërkon reagime të shpejta dhe të koordinuara. Me një organizim efikas dhe bashkëpunim të ngushtë mes të gjitha sektorëve, arritëm të përballojmë me sukses çdo situatë që preku shëndetin e kafshëve dhe bimëve. Krenohemi me faktin se e përmbyllëm vitin pa asnjë rast helmimi të raportuar.

Që nga fillimi i mandatit tim, jam udhëhequr nga parimi i transparencës dhe kam vlerësuar lartë rëndësinë e informimit në kohë të qytetarëve. Kemi ndërtuar dhe kultivuar një komunikim të hapur me të gjitha grupet e interesit, duke shpërndarë në kohë informacione të rëndësishme që kërkonin ndërgjegjësim dhe ndryshim të sjelljes. Përmes veprimeve të shpejta dhe të koordinuara, parandaluan përhapjen e sëmundjeve infektive, të cilat kishin prekur vendet fqinje dhe rajonin, duke ndërmarrë masa të duhura kufizuese dhe kontrole në pikat kufitare.

Në kontrollin e brendshëm, kemi rritur kapacitetet teknike dhe kemi funksionalizuar objektet e zyrave regjionale, duke ofruar qasje më të lehtë për qytetarët dhe kushte më të mira pune për inspektorët tanë në terren, të cilët ofrojnë shërbime të drejtpërdrejta për fermerët dhe bizneset. Megjithatë, përballuam edhe sfida siç ishte transferimi i Inspektoratit Sanitar nën Ministrinë e Shëndetësisë – një ndryshim i kuadrit ligjor që ndikoi në strukturën e AUV-së.

Digjitalizimi i shërbimeve përbën një tjetër arritje të rëndësishme të këtij viti. Përveç që ka lehtësuar qasjen e qytetarëve dhe bizneseve në shërbime, ka përmirësuar dukshëm efikasitetin e brendshëm të punës së agjencisë. Po ashtu, gjatë vitit 2024, kemi ndërmarrë hapa të rëndësishëm në forcimin e standardeve inspektuese, modernizimin e infrastrukturës dhe avancimin e kornizës ligjore, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Sukseset e arritura gjatë vitit 2024 janë rezultat i përkushtimit dhe profesionalizmit të të gjithë punonjësve të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë, si dhe mbështetjes së çmuar të partnerëve tanë vendorë dhe ndërkombëtarë. Në mënyrë të veçantë, shpreh falënderimet e mia për Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, për bashkëpunimin e ngushtë dhe përkrahjen e pakursyer gjatë gjithë vitit.

Ky raport paraqet një pasqyrë të qartë të punës sonë të përbashkët, sfidave të përballuara dhe rezultateve të arritura, duke vendosur themele të forta për vitin e ardhshëm.

Bekim Hoxha

Drejtor Ekzekutiv i Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë

Hyrje

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) vazhdon të luaj një rol kyç në garantimin e shëndetit publik, mbrojtjen e konsumatorëve dhe përmirësimin e standardeve të sigurisë ushqimore dhe mirëqenies së kafshëve në vend.

Agjencia e Ushqimit, që nga hyrja në fuqi e Ligjit Nr. 03/L-016 "Për Ushqimin" më 12 gusht 2022, funksionon si një institucion i rëndësishëm në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZhR). Ky pozicionim i saj reflekton angazhimin për të zbatuar dhe mbikëqyrur standardet e sigurisë ushqimore dhe për të kontribuar në përmirësimin e shëndetit publik dhe mirëqenies në vend.

Raporti Vjetor i Punës (RVP) për vitin 2024 përshkruan në detaje veprimtarinë e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) si autoritet kompetent në Kosovë për sigurinë e ushqimit, shëndetin dhe mirëqenien e kafshëve, si dhe shëndetin e bimëve. Dokumenti pasqyron aktivitetet kryesore të agjencisë, përfshirë inspektimet, monitorimet, mostrat, dhe mbikëqyrjen, në përputhje me detyrimet ligjore dhe Planin e Kontrollit Zyrtar. Raporti përfshin veprimtaritë e njësive organizative të AUV-së, duke mbuluar çështjet veterinare, fitosanitare, analizat laboratorike, aspektet administrative, juridike, logjistike, dhe menaxhimin financiar. AUV-ja, si pjesë e MBPZHR-së, ka zbatuar kontrole zyrtare në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe rregulloret e Bashkimit Evropian, në kuadër të Planit Kombëtar të Zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit (PKZMSA).

Falë bashkëpunimit me institucione vendore dhe ndërkombëtare, AUV ka forcuar kapacitetet e saj dhe ka vendosur standarde të larta në fushën e inspektimeve dhe shërbimeve laboratorike. Gjithashtu, veprimet konkrete për largimin e produkteve të dyshimta nga tregu dhe masat për kontrollin e kafshëve shoqëruese janë shembull i angazhimit për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe për të mbrojtur konsumatorët.

Këto arritje janë rezultat i përkushtimit të stafit profesional, mbështetjes së partnerëve dhe angazhimit të vazhdueshëm për të mbajtur standardet më të larta në sigurinë ushqimore dhe shëndetin publik, duke mbrojtur në të njëjtën kohë interesat e qytetarëve dhe të komunitetit të fermerëve.

PËRMBAJTJA

Fjala hyrëse	3
Hyrje	4
Lista e tabelave	7
Lista e Figurave	8
Lista e shkurtesave	9
ZYRA E DREJTORIT EKZEKUTIV	10
1. ZYRA PËR KOMUNIKIM ME MEDIA	10
2. ARKIVA	15
3. ZYRA E TI-SË	16
4. SEKTORI I PERSONELIT	17
5. ZYRTARI ÇERTIFIKUES	20
6. SEKTORI I PROKURIMIT	20
DREJTORIA E INSPEKTORATIT	21
1. SEKTORI I BRENDSHËM VETERINAR DHE FITOSANITAR	22
1.1. KONTROLLI I BRENDSHËM VETERINAR	22
1.2. KONTROLLI I BRENDSHËM FITOSANITAR	26
2. SEKTORI KUFTIAR VETERINAR DHE FITOSANITAR	29
2.1. KONTROLLI KUFITAR VETERINAR	30
2.2. KONTOLLI FITOSANITAR KUFITAR	31
DREJTORIA E SHËNDETIT DHE MIRËQENIES SË KAFSHËVE	37
1.0. REALIZIMI I PROGRAMEVE PËR PARANDALIMIN E PËRHAPJES SË SËMUNDJEVE INFEKTIVE TË KAFSHËVE	37
2.0. HULUMTIMET DIAGNOSTIKE NË SËMUNDJET INFEKTIVE TË KAFSHËVE	38
GJURMIMI PASIV	38
3. ASGJËSIMI I KAFSHËVE QË KANË REZULTUAR POZITIV NË SËMUNDJET INFEKTIVE 39	
4. APROVIMI- LICENSIMI I OPERATORËVE TË BIZNESIT	39
5. IDENTIFIKIMI DHE REGJISTRIMI I KAFSHËVE	39
6. AUTORIZIMI I MARKETINGUT PËR PRODUKTET MJEKËSORE VETERINARE	45
DREJTORIA E SHENDETIT PUBLIK	47
1. APROVIMI DHE MONITORIMI I PLANIT VJETOR TË KONTROLLEVE ZYRTARE DHE MOSTRIMIT 2023	47
2. PLANI I MBETJEVE	47
3. APROVIMI DHE REGJISTRIMI I OBU-VE	48
4. FABRIKA PËR TRAJTIMIN E NËNPRODUKTEVE SHTAZORE	49

5.	MUNDËSIMI I PJESËMARRJES SË PRODUKTEVE VENDORE NË TREGUN NDËRKOMBËTAR.....	50
6.	HARTIMI I AKTEVE NORMATIVE	50
	LABORATORI I USHQIMIT DHE VETERINARISË	51
1.	MENAXHIMI I CILËSISË – AKTIVITETET E REALIZUARA	52
2.	MIKROBIOLOGJIA E USHQIMIT – AKTIVITETET E REALIZUARA	52
3.	KIMIA USHQIMORE.....	54
4.	LABORATORI I ANALIZAVE TË QUMËSHTIT	61
5.	PATO- HISTOLOGJIA	62
6.	BAKTEROLOGJIA ME PARASZITOLOGJI	63
	PJESËMARRJE NË PT-TEST.....	64
7.	SEROLOGJIA DHE DIAGNOSTIKA MOLEKULARE.....	64
	DREJTORIA E ADMINISTRATËS.....	70
1.1.	ZYRA LIGJORE	71
	AKTE NËNLIGJORE TË PËRGATITURA	71
	AKTIVITETE TË TJERA LIGJORE	71
3.0.	LOGJISTIKA	72
4.0.	ZYRTARI I PASURISË	72
5.0.	SEKTORI PËR BUXHET DHE FINANCA	73
	PËRFUNDIME	79

Lista e tabelave

Tabela 1 Numri i përgjithshëm vjetor i inspektimeve dhe motrave gjatë vitit 2024	22
Tabela 2. Plani i kontrolleve zyrtare nga inspektorati veterinar i brendshëm.....	23
Tabela 3 Mostrat e dorëzuara në LUV	24
Tabela 4 Numri vjetor i inspektimeve dhe mostrave të marra nga Inspektorati Veterinar i Brendshëm, sipas tremujorëve.	25
Tabela 5 Numri dhe aktivitetet inspektuese nga Inspektorati Veterinar i Brendshëm.....	25
Tabela 6 Numri dhe lloji i inspektimeve të kryera nga Inspektorati Fitosanitar i Brendshëm.....	27
Tabela 7 Plani i monitorimit të mbetjeve	31
Tabela 8 Numri vjetor i inspektimeve dhe mostrave të marra nga Inspektorati Veterinar Kufitar, sipas tremujorëve	31
Tabela 9 Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2024	32
Tabela 10 Ngarkesat e refuzuara gjatë vitit 2024.....	33
Tabela 11 Vaksinimet e kafshëve.....	37
Tabela 12 Hulumtimet diagnostike në terren.....	38
Tabela 13 Asgjësimi i kafshëve	39
Tabela 14 Licensimi/ Aprovimi i OB	39
Tabela 15 Raportimi i lindjeve të kafshëve sipas llojeve dhe komunave- FCMS.....	40
Tabela 16 Raportimi i lindjeve të kafshëve sipas llojit dhe komunës- InterTrace.....	42
Tabela 17 Raportimet e aktiviteteve tjera sipas llojeve të kafshëve	44
Tabela 18 Aktivitetet tjera në funksion të sistemit I&R	45
Tabela 19 Mostra e planit të mbetjeve.....	47
Tabela 20 Objektet e regjistruara të ushqimit me prejardhje jo-shtazore	49
Tabela 21 Aprovimi i operatorëve me nënprodukte shtazore	49
Tabela 22 Testimet në LUV gjatë viteve 2022-2024'	52
Tabela 23 Parametrat dhe mostrat e testuara.....	52
Tabela 24 Kërkesat dhe mostrat për testim.....	54
Tabela 25 PJESËMARRJA NË TESTE TË PROFICIENCËS	60
Tabela 26 Numri i mostrave të patestuara.....	60
Tabela 27 Mostrat e dërguara jashtë vendit për testim.....	60
Tabela 28 Tabela e kalsifikimit të qumështit sipas ngarkesës mikrobiale	62
Tabela 29 Ekzaminimet gjatë vitit 2024.....	62
Tabela 30 Sëmundjet e testura gjatë vitit 2024.....	63
Tabela 31 Mostrat e pranuar gjatë vitit 2024.....	64
Tabela 32 Testet e kryera gjatë vitit 2024	65
Tabela 33 Ecuria e punës gjatë vitit 2024	68
Tabela 34 Pjesëmarrja në teste të proficiencës	68
Tabela 35 Të hyrat sipas kodeve	77

Lista e Figurave

Figura 1 Statistikat e komunikimit gjatë vitit 2024	14
Figura 2 Certifikatat e lëshura nga inspektorati fitosanitar i brendshëm	29
Figura 3 Objektet e aprovuara të ushqimit me prejardhje shtazore dhe aktiviteti i tyre.....	48
Figura 4 Mostat e pranuar dhe të testuara (2023-2024).....	61

Lista e shkurtesave

ADIS	Animal Diseases Information System
ARC	Agjencia për Regjistrim Civil
ARBK	Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë
ASHI	Agjencia e Shoqërisë së Informacionit
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
AUV	Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë
FCMS	Sistemi i Kontrollit dhe Gjurmëshmërisë së Ushqimit
IBK	Instituti Bujqësor i Kosovës
IKSHPK	Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës
DSHP	Drejtorja e Shëndetit Publik
DSHMK	Drejtorja e Shëndetit dhe Mirëqenies së Kafshëve
LIMS	Sistemi Informativ i Menaxhimit të Laboratorit
LUV	Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë
MAD	Murtaja Afrikane e Derrit
MBPZhR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërtimtarisë dhe Tregtisë
MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit
RASFF	Rapid Alert System for Food and Feed
SCPE	Sistemi i Pagesave dhe Çertifikatave Elektronike
WOAH	World Organisation for Animal Health

ZYRA E DREJTORIT EKZEKUTIV

1. ZYRA PËR KOMUNIKIM ME MEDIA

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë gjatë vitit 2024 shënoi sukses të dukshëm në menaxhimin e sëmundjeve infektive, duke mos regjistruar asnjë shpërthim të tillë. Ky rezultat pozitiv ndikoi ndjeshëm në uljen e intensitetit të komunikimit në këtë fushë, duke reflektuar një situatë të qëndrueshme dhe nën kontroll.

Prioriteti ynë kryesor është informimi dhe komunikimi i saktë me konsumatorët në Republikën e Kosovës. Këtë qëllim e kemi arritur përmes punës sonë të përkushtuar dhe komunikimit të shpejtë dhe të saktë në rrjetet tona të komunikimit.

Viti 2024 është përcjellur me largime të disa produkteve ushqimore nga tregu të cilat nuk i kanë plotësuar kriteret ligjore për konsum. Siguria ushqimore është një nga fushat më komplekse dhe sfiduese. AUV i ka menaxhuar situatat me profesionalizëm, duke i mbajtur qytetarët të mirëinformuar.

Kjo është realizuar përmes zbatimit të strategjisë së komunikimit dhe planit të veprimit, i cili përfshin të gjitha fazat e procesit: nga ngritja e dyshimeve për helmim, te faza e hetimit dhe përgatitjes së raporteve përfundimtare, deri te komunikimi pas publikimit të rezultateve për shkakun e incidentit. Kjo qasje e strukturuar ka siguruar transparencë dhe qetësim të shqetësimeve publike

AUV zbaton sistemin RASFF (Rapid Alert System for Food and Feed), duke siguruar një reagim të shpejtë dhe efikas ndaj rasteve të raportuara. Të gjitha incidentet e lajmëruara nga RASFF janë komunikuar në mënyrë të plotë dhe transparente me mediat, duke garantuar informim të shpejtë dhe të saktë. Ky sukses është rezultat i bashkëpunimit të ngushtë dhe profesional me të gjitha mediat, duke kontribuar në përhapjen e informacionit të besueshëm dhe në kohë për publikun.

KOMUNIKIMI NË PARAQITJE TË SËMUNDJEVE MAD (MURTAJA AFRIKANE E DERRIT), AVIAN INFLUENCA DHE MURTAJA E RUMINATËVE TË VEGJËL

Pas raportimit për shpërthimin e sëmundjeve infektive MAD, Murtaja e Ruminatëve të Vegjël dhe Avian Influenca të raportuara nga nga oranizata WOA (World Organization for Animal Health)

dhe ADIS (Animal Disease Information System). Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV) menjëherë ka informuar publikun, fermerët dhe konsumatorët për të ndaluar importin e kafshëve/shpezëve nga zonat me sëmundje ngjitëse dhe ka udhëzuar fermerët të zbatonin masat e biosigurisë. Kontrolli në kufi ishte forcuar, dhe çdo ndryshim i situatës ishte njoftuar me kohë. Konsumatorët ishin informuar për të shmangur panikun, ndërsa njoftimet ishin shpërndarë në media vendore dhe ndërkombëtare. Gjithashtu është vendosur një numër kontakti 24/7 për raportimin e rasteve të dyshuara.

MIRËMBAJTJA E UEBFAQES ZYRTARE [HTTPS://AUVK.RKS-GOV.NET/](https://auvk.rks-gov.net/) DHE RRJETIT SOCIAL NË FACEBOOK

Rrjeti social zyrtar i AUV-së ka qenë aktiv dhe i azhurnuar me informata nga puna e institucionit, duke përbushur kriteret e transparencës dhe informimit të qytetarëve e grupeve të interesit. Uebfaqja zyrtare, auvk.rks-gov.net, e ndërtuar sipas rregullave ligjore dhe e hostuar në serverë shtetërorë, ofron qasje të lehtë. Megjithatë, ka pasur ngecje në azhurnimin e informatave për shkak të moszbatimit dhe mosrinovimit të kontratave.

Lista dhe rubrikat për disa sektorë janë të paplota, dhe operatori kontraktues ka pasur vonesa në publikimin e materialeve. Konsumatorët, bizneset dhe fermerët kanë qasje në informacione të dobishme për sigurinë ushqimore dhe shëndetin e kafshëve e bimëve, me përjashtim të listave më të fundit.

Rrjetet sociale, sidomos Facebook, kanë shënuar rritje në shikueshmëri dhe reagime, sidomos gjatë njoftimeve për rreziqe. Publikimi i informatave në kohë reale ka ndihmuar mediat të citojnë kanalet zyrtare të AUV-së.

Por vazhdon të nevojitet dizajnimi i një logoje unike për AUV-në për të krijuar identitet vizual të veçantë. Numri i postimeve këtë vit ka tejkaluar atë të vitit të kaluar.

QASJA NE DOKUMTET PUBLIKE

Gjatë vitit 2024 AUV ka trajtuar me sukses 28 kërkesa për qasje në dokumente publike. Në rastet kur dokumentet e kërkuara nuk ekzistonin ose ishin në posedim të institucioneve të tjera, palët janë informuar dhe udhëzuar përkatësisht. Për kërkesat që përfshinin një numër të madh dokumentesh,

janë shfrytëzuar afate kohore shtesë, në koordinim me Agjencinë për Informim dhe Privatësi, duke siguruar që palët të marrin informacionin e kërkuar.

Drejtori Ekzekutiv i AUV-së ka qenë i vendosur për të ruajtur transparencën ndaj mediave dhe qytetarëve.

Kërkesat nga palët e jashtme kanë qenë të larmishme, duke përfshirë media, gazetarë dhe individë nga fusha të ndryshme, të cilët kryesisht kanë kërkuar statistika, raporte, procesverbale dhe dokumente financiare. Për dokumentet që ishin tashmë online, janë ofruar lidhjet përkatëse. Në 7 raste, qasja ka qenë e pjesshme për shkak të mungesës së disa dokumenteve. Shumica e dokumenteve janë dërguar në formë elektronike ose kopje fizike, direkt nga zyra për informim, me vendimet për qasje të përgatitura nga kjo zyrë, rishikuar nga zyra ligjore dhe nënshkruar nga Drejtori Ekzekutiv. Palët janë mbajtur të informuara gjatë gjithë procesit.

RAPORTI ME MEDIA

AUV ruan marrëdhënie të forta me mediat dhe gazetarët, duke e konsideruar këtë bashkëpunim thelbësor. Komunikimi efektiv me mediat është kyç për të siguruar që masat e ndërmarra nga AUV të jenë të pranueshme dhe të zbatueshme nga publiku.

Zyra për Komunikim e AUV ndjek parimin e trajtimit të barabartë të të gjitha mediave, duke ofruar përgjigje të shpejta dhe të sakta, si dhe duke asistuar gazetarët në marrjen e informacioneve të nevojshme. Kjo përfshin ofrimin e dokumenteve, mundësinë e ndjekjes së aktiviteteve në terren dhe organizimin e intervistave me specialistë të fushës.

Përveç mediave kombëtare, AUV komunikon edhe me mediat lokale dhe ato të vendeve fqinje, duke pasur parasysh ndikimin e tij në jetën e përditshme të qytetarëve lokalë dhe ndërkufitarë. Ky angazhim ka rezultuar në një prani të rregullt të AUV në programet mediatike dhe në mbulimin e aktiviteteve të tij.

Vlerësimet e jashtme tregojnë se AUV bën pjesë në grupin e institucioneve me marrëdhënie të mira me mediat dhe transparencë ndaj publikut. Ky bashkëpunim i ngushtë me mediat ka qenë vendimtar në menaxhimin e situatave të ndjeshme dhe në përçimin efektiv të mesazheve te publiku.

AUV monitoron rregullisht mediat, rrjetet sociale dhe influencuesit për çështje që lidhen me fushën e tij, veçanërisht në situata që kërkojnë vëmendje të shtuar. Përmes raportit të mirë me gazetarët dhe analizës së informatave, institucioni siguron reagim të saktë dhe të shpejtë

KOMUNIKIMI ME QYTETARËT

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë fokus kryesor i ka qytetarët dhe sigurinë ushqimore për ta, duke ofruar kanale të shumta komunikimi për të lehtësuar raportimin dhe marrjen e informacioneve.

Kanale të komunikimit të ofruara nga AUV për qytetarët:

- **Linja e gjelbër pa pagesë:** Në bashkëpunim me Doganat dhe Policinë, AUV ka funksionalizuar linjën e gjelbër 0800 50095 dhe numrin për mesazhe SMS 050095, të disponueshme 24/7 për raportime nga qytetarët.
- **Zyra në Qendrën Kombëtare për Menaxhimin e Kufirit (QKMK):** AUV ka një zyrtar të pranishëm gjatë orarit të rregullt në QKMK, ndërsa jashtë orarit, zyrtarët doganor dhe policor kujdestarojnë për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit.
- **Uebfaqja zyrtare:** Përmes formularit online në uebfaqen e AUV-së, qytetarët mund të raportojnë çështje të ndryshme, të cilat më pas shpërndahen tek sektorët përkatës për trajtim.
- **Rrjetet sociale:** AUV është aktive në platforma si Facebook, ku pranon ankesa dhe informacione nga konsumatorët, duke ndihmuar në identifikimin dhe largimin e produkteve të dyshimta nga tregu.


Për të inkurajuar bashkëpunimin me qytetarët, AUV shpesh informon raportuesit për veprimet e ndërmarra bazuar në raportimet e tyre, duke forcuar besimin dhe nxitjen e raportimeve aktive për mbrojtjen e shëndetit publik. Në bashkëpunim me Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), AUV zhvillon fushata për promovimin e të drejtave të konsumatorëve, duke theksuar rëndësinë e informimit dhe aktivizimit të tyre për të mirën e përgjithshme.

LAJMET E PRODHUARA

AUV është institucion me interes të lartë publik, veçanërisht për shëndetin e kafshëve, bimëve dhe sigurinë ushqimore. Situatat si sëmundjet infektive apo incidentet ushqimore kërkojnë komunikim të vazhdueshëm dhe të saktë me mediat. Këtë vit, numri i informatave ishte më i ulët, pasi që Inspektorati Sanitar nuk është më pjesë e AUV-së.

Vlen të theksohet se një incident lidhur me tregtimin e mishit me Shqipërinë dëmtoi përkohësisht imazhin e AUV-së, por përmes komunikimit transparent dhe hetimeve të plota, institucioni dëshmoi se nuk kishte shkelje. Kjo përforcoi besimin publik dhe tregoi përkushtimin ndaj transparencës dhe përgjegjësisë.

Figura 1 Statistikat e komunikimit gjatë vitit 2024



Burimi: Zyra e komunikimit, AUV

BASHKËPUNIMET E AUV-SË

INSTITUCIONET VENDORE:

- Në radhë të parë me Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në kuadër të cilës ndodhet Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë që nga viti 2022;

- Bashkëpunim i ngushtë me Ministrinë e Shëndetësisë, Zyrën e Kryeministrit dhe mekanizmat e sigurisë për menaxhimin e situatave të rrezikut;
- Angazhim i organeve si policia, pushteti lokal dhe shoqatat e fermerëve për menaxhimin e shpërthimeve të sëmundjeve infektive.

Menaxhimi i Integruar i Kufirit (MIK):

- Bashkëpunim efektiv mes AUV-së, Policisë së Kosovës dhe Doganave të Kosovës, përmes kanaleve të përbashkëta të komunikimit.

BASHKËPUNIME NDËRKOMBËTAR:

- Takime virtuale dhe aktivitete me organizata si EFSA, OIE, FAO, OBSH.
- Kontakt i vazhdueshëm me Autoritetin Evropian të Sigurisë Ushqimore (EFSA) përmes rrjetit të komunikimit dhe pike kontaktuese.
- Marrëveshje e bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë së Kroacisë për Bujqësi dhe Ushqim dhe Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë së Kosovës, me qëllim përmirësimin e sigurisë ushqimore.

2. ARKIVA

Arkiva e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë luan një rol kyç në ruajtjen dhe administrimin e dokumentacionit zyrtar, duke garantuar qasje të rregullt dhe të organizuar në të dhëna për të mbështetur transparencën dhe funksionimin efikas të institucionit,

Gjatë vitit 2024 në arkivën e AUV-së janë protokoluara gjithsej **13,905** lëndë në total nga (Drejtoria Ekzekutive, Drejtoria e Shëndetit Publik, Drejtoria e Shëndetit dhe Mirëë Kafshëve, Drejtoria e Inspektoratit, Drejtoria e Administratës dhe Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë).

Në kuadër të aktiviteteve të arkivës janë protokoluara **4,321** Analiza nga (Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë, Insitucioni Bujqësor i Kosovës dhe Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës).

Këto të dhëna pasqyrojnë përkushtimin e Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë në mirëmbajtjen e një sistemi efikas dhe transparent të arkivimit, duke siguruar qasje të organizuar në

dokumentacionin zyrtar për të mbështetur funksionimin e qëndrueshëm të institucionit dhe avancimin e misionit të tij për mbrojtjen e shëndetit publik dhe mirëqenien e kafshëve

3. ZYRA E TI-SË

Gjatë vitit 2024, sektori i TI-së në AUV është angazhuar në mirëmbajtjen e sistemeve softuerike, menaxhimin e pajisjeve dhe llogarive qeveritare, trajnimin e stafit, përgatitjen e specifikimeve teknike dhe menaxhimin e kontratave.

SISTEMET SOFTUERIKE

Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë përdor aktualisht sistemet e mëposhtme softuerike:

- Sistemi i Pagesave dhe Çertifikatave Elektronike (SCPE),
- Sistemi i Identifikimit dhe Regjistrimit të Kafshëve,
- Sistemi i Kontrollit dhe Gjurmëshmërisë së Ushqimit (FCMS)
- Sistemi Informativ i Menaxhimit të Laboratorit (LIMS).

Në fillim të vitit, me kërkesë të Thesarit, kemi ndryshuar UNIREF-in në sistem. Megjithatë, bankat komerciale kanë hasur probleme dhe nuk i kanë implementuar ndryshimet në kohë

Sistemi SCPE edhe këtë vit shkëmben çertifikatat fitosanitare përmes sistemit SEED+, system i cili ka funksionuar online edhe gjatë festave dhe vikendeve. Ky system përmes platformës GG bën shkëmbin e të dhënave me Doganën e Kosovës dhe sistemin e QKMK-së.

Sistemi FCMS janë funksionalizuar pothuajse të gjitha modulet e sistemit FCMS, migruar të dhënat nga sistemi i vjetër dhe kryer të gjitha regjistrimet, inspektimet dhe pëlqimet sanitare përmes tij. Është trajnuar stafi dhe praktikantët veterinarë, ndërsa sistemi vazhdon të shkëmbejë të dhëna me ARBK dhe ARC

Sistemi LIMS është funksional për gjithë laboratorin, duke gjeneruar raportet dhe rezultatet e testimeve. Janë hartuar specifikat për mirëmbajtje dhe zhvillim të mëtejshëm.

Kemi përgatitur specifikat për pajisje TI për kontrata me harduer dhe sistemet SCPE dhe FCMS. Kompjuterët dhe laptopët i shfrytëzojmë nga AQP, ndërsa pajisjet tjera i specifikojmë vetë.

MENAXHIMI I LLOGARIVE QEVERTARE

Kemi menaxhuar 300 llogari të stafit të AUV, me probleme nga sulmet kibernetike. Procedurat për krijim, resetim dhe deaktivizim janë ndjekur sipas rregullores, dhe kërkesat janë përgjigjur në kohë. Për llogaritë e infektuara, kemi kërkuar mbështetje nga ASHI.

TRAJNIME

Gjatë vitit, kemi trajnuar vazhdimisht stafin e AUV-së, duke përfshirë Inspektoratin, Praktikat Veterinare dhe stafin tjetër, në përdorimin e sistemit FCMS. Me mbështetje nga IKAP, organizuam një trajnim njëditor për ‘Higjienën Kibernetike’. Stafi ka nevojë për trajnime bazike, veçanërisht për sistemet operative dhe paketën Office, pasi shumë probleme lidhen me mungesën e njohurive. Vizituam të gjitha Zyret Regjionale dhe ofruam trajnime shtesë për përdorimin e sistemeve dhe pajisjeve të TI-së.

MENAXHIMI I KONTRATAVE

- Furnizim me pajisje të TI-së
- Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira
- Furnizimi me toner
- Internet në zyret e Identifikimit dhe Regjistrimit

4. SEKTORI I PERSONELIT

1. Menaxhimi i Sektorit të Personelit; Menaxhimi i punëve që ndërlidhen me: Sistemin për Informimin dhe Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ); Sistemin për Menaxhimin dhe Arkivimin Elektronik të Dokumenteve (SMAED); Sistemin për Menaxhimin e Vijueshmërisë në Punë (SMVP); Sistemin e Pagave; Sistemin e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, etj.;

2. Bashkëpunim me Nëpunësit dhe njësitë organizative përkatëse të AUV;

3. Bashkëpunim me Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik; Thesarin e Kosovës-Sektorin e Pagave; Ministrinë e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit; Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Agjencioni për Parandalimin e Korrupsionit etj.;

4. DMZP/ SIMBNJ: Draft Plani dhe Plani Individual i Personelit, etj.; Pozitat e Punës në AUV; Aktivizim të user, aktivizim të moduleve përkatëse në SIMBNJ, kufizim të qasjes përtej njësisë përkatëse, etj.;
5. Plani Vjetor i Punës/Vlerësimi i Performancës: Planit Vjetor i Punës për nëpunësit; Procedura e vlerësimit të performancës së nëpunësve, etj.;
6. Administrimi i nëpunësit/Kontratat e nëpunësit/Profili i nëpunësit: Përditesimi i të dhënave dhe dokumenteve përkatëse për caktim të mbikeqyresit sipas njësive organizative; Konfirmimi si pjesë e dosjes i të dhënave dhe dokumenteve përkatëse mbi edukimin, informatat e pozitës së punës; Përvojën e punës, të dhënave baze për nëpunësit, etj.;
7. Administrimi i nëpunësit/Procedurat e transferimit/ Procedurat e përfundimit të akt emërimit: Përditesimi i të dhënave të kërkuara dhe dokumenteve përkatëse për transferim të nëpunësve; Transferimi i dosjeve elektronike të Inspektoreve Sanitar në Ministrinë e Shëndetësisë; Përfundim të Akt Emërimit; Përfundim të marrëdhënies së punës, etj.;
8. Administrimi i nëpunësit/Kërkesat për Pushim: Gjenerimi i raporteve të pushimeve për nëpunësit. Shqyrtimi i ditëve të pushimit vjetor të kalkuluara nga sistemi, si dhe evidentimi i të dhënave për plotësim/ndryshim; Përditesimi i të dhënave mbi ditët e pushimit vjetor sipas përvojes së punës, ditët e pushimit të bartura nga viti paraprak, ditët retroaktive sipas Vendimit të Gjykatës Kushtetuese, etj.; Përditesimi i të dhënave sipas kërkesave për pushim vjetor, mjekësor, sipas udhëtimeve zyrtare, pushimit pa pagesë, etj.;
9. Procedurat e Rekrutimit/Verifikimi Paraprak/Vlerësimi i aplikantëve/Akt Emërimi: Janë inicuar trembëdhjetë (13) procedura, për gjithsej njëzet e shtatë (27) pozita; Pjesëmarrja, në cilësinë e anëtarit nga Sektori i Personelit në komisionet e pranimit për vlerësimin profesional në Shërbimin Civil, në procesin e testimit me shkrim në DMZP, si dhe në intervistim; Verifikimi paraprak, janë shqyrtuar gjashtëqind e tridhjetë e pesë (635) aplikacione me dokumentet përkatëse, të aplikantëve në procedurat e rekrutimit për pranim në AUV, për pozitat përkatëse; Janë hartuar dhe proceduar nëpërmjet e-mail përkatëse në SIMBNJ, i treqind e shtatëdhjetë e shtatë (377) vendimeve/njoftimeve për refuzim të aplikacioneve të aplikantëve që nuk kanë plotësuar kriteret e kërkuara të konkursit, sipas procedurave; Janë hartuar dhe publikuar në SIMBNJ njoftimit me listën e kandidatëve që kanë plotësuar kriteret e konkursit, për njëmbëdhjetë (11) procedura; Janë aprovuar aplikacionet e aplikantëve, dhe procedimi i ftesave për pjesëmarrje në testim me shkrim, sipas procedurave përkatëse për dyqind e pesëdhjetë e tetë (258) kandidatë; Nga testimi.rks-gov.net janë gjeneruar dhe vlerësuar njëqind e tridhjetë e tetë (138) ese të kandidatëve pjesëmarrës në testim me shkrim, për pozitat përkatëse; Janë vlerësuar njëzet e një (21) kandidate nga pjesëmarrja në intervistë, për pozitat përkatëse; Janë hartuar dhe publikuar në SIMBNJ njoftimet për publikim të rezultateve përfundimtare, përkatësisht në fazën e afatit të ankesave për tetë (8) procedura të përfunduara, për dymbëdhjetë (12) pozita; Është hartuar dhe publikuar në SIMBNJ njoftimi për anulim të një (1) procedure të rekrutimit për pranim, për një (1) pozitë; Është përfunduar pjesërisht e suksesshme një (1) procedurë; Është përfunduar e dështuar një (1) procedurë; Janë përfunduar të suksesshme tre (3) procedura; Në fazën e afatit të ankesave tre (3) procedura;

10. Janë përditësuar të dhënat dhe dokumentet e kërkuara për emërim në pozitë në SIMBNJ të kandidatëve të emëruar në pozitë;

11. Sektori i Pagave/Thesari i Kosovës: Procedimi i të dhënave të kërkuara për përditësimin e të dhënave të kërkuara për Sistemin e Pagave/Listën e Pagave; Procedimi i formularëve dhe shkresave përkatëse për ndryshime në Listën e Pagave; Gjenerimi nga sistemi i dymbëdhjetë (12) Lista të Pagave, si dhe raporteve financiare, për vitin 2024. Verifikimi i aplikimit të ndryshimeve të proceduara nga Sektori i Personelit, etj.;

12. Përditësimi dhe procedimi i të dhënave të kërkuara, për kompensim të praktikantëve të angazhuar sipas kontratës për punë praktike në AUV;

13. Komisionin Disiplinor: Sipas kërkesave përkatëse, janë proceduar në Komision Disiplinor kërkesa për inicim të procedurave disiplinore ndaj nëpunësve; Pjesëmarrja në seanca të Komisionit Disiplinor. Hartimi dhe procedimi i dy (2) procesverbaleve; Janë nxjerr dy (2) vendime të Komisionit Disiplinor, ndaj dy (2) nëpunësve, etj;

14. Zyra Kombetare e Auditimit: Sipas kërkesës janë permbledhur dhe proceduar (mostra) dokumente të nepunesve, siç janë: Akt Emërimi, vendime, Listat e Pagave, raportet e vijueshmërisë në punës, etj; si dhe tabela me të dhënat: emri/mbiemri, pozita e punës, njësia organizative, si dhe nëpunësit në pushim pa pagesë, rekrutimet, pensionimet, përfundimet e marrëdhënies së punës, ndërprerjet, etj;

15. ASHI për Sistemin i Menaxhimit të Vijueshmerise: Menaxhimi I perdoruesve/nepunesve ne sistem: roli, hierarkia, departamenti, etj.; Gjenerimi I raporteve individuale/ njesive perkatese mbi vijueshmerine ne pune; Evidentimi manual I vijueshmerise ne pune, etj.;

16. SMAED – deklarimi i të dhënave të kërkuara/foto përkatëse, si dhe procedimi i kërkesave për pajisje me ID zyrtare për nëpunësit/konsulent individual, etj.;

17. Bashkepunim me IKAP - Procedim i ftesave/agjendave për pjesëmarrje në trajnime të organizuara nga IKAP; Konfirmimi i nepunesve pjesemarres, etj;

18. Agjencia per Parandalimin e Korrupsionit – Menaxhimi/Perditesimi i te dhenave mbi proceduren e përfundimit të funksionit në sistem; Regjistrimin e zyrtareve për deklarin; Bashkëpunim me administratorët/nëpunës të TI-së në APK, etj.;

19. KPMSHCK/Avokatura Shtetërore: Hartimi i shkresave percjellese si dhe permbledhja dhe procedimi i dokumenteve te kerkuara per shqyrtim te ankesave, etj;

20. Kërkesat për Qasje në Dokumente Publike – Bashkepunim ne permbledhjen dhe procedimin e dokumenteve sipas kerkesave perkatese, etj.;

21. Punë të tjera administrative: Janë krijuar dosje fizike pasive, sipas dokumenteve origjinale të dosjeve fizike të ish nëpunësve, për transferim të tyre në posedim të Ministrisë së Shëndetësisë, për: pesëdhjetë e katër (54) nëpunës; Finalizimi i fajllimit të pesëdhjetë e katër (54) dosjeve fizike të nëpunësve të Inspektoratit Sanitar, për dorëzim tek Ministria e Shëndetësisë; Perditesimi i te dhenave te kerkuara per nepunesit sipas njesive perkatese siç janë: emri/mbiemri, pozita e punës,

numri në listën e pagave (EM), klasa, koeficienti, niveli i edukimit, vitet e përvojës së punës, etj.; Perditesimi i te dhënave të nëpunësve mbi vërtetimin, përkatësisht mbi verifikimin e të kaluarës kriminale nga Policia e Kosovës; Procedimi i njoftimit tek Sektori i Teknologjisë Informative, dhe Sektorit të Prokurimit, mbi dorëheqjen, pensionimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, se nëpunësve; Tek Sektori i Teknologjisë Informative janë proceduar kërkesat me të dhënat e kërkuara/aprovuara, për resetim të fjalëkalimit të e-mail zyrtar, hapje të llogarisë për nëpunës; Procedimi i të dhënave dhe dokumenteve sipas kërkesës për pergjigje për raportin e inputit për Komisionin Europian; Përgjigje në kërkesën për Kapitullin 12, mbi procedurat e rekrutimit për pranim, për pozitën Inspektor Veterinar Kufitar, dhe Inspektor Fitosanitar Kufitar; Qarkorja Buxhetore 2025/1. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinnor, është finalizuar procesi i kalkulimit mujor të vlerës së kompensimit të pagës për nëpunësit, për periudhën Qershor-Dhjetor 2023, për dyqind e tridhjetë (230) nëpunës, si dhe për periudhën Janar-Maj 2024, për njëqind e gjashtëdhjetë e shtatë (167) nëpunës, siç janë: pagat dhe mëditjet të ndarë në gjini në nivelet e pagave (301-400; 401-600; 600+). Gjithashtu është paraqitur numri i pozitave të planifikuara për vitin 2025; Hartimi i vendimeve për pushim të lehonisë së nëpunësve; Hartimi dhe aprovimi i vërtetimit mbi marrëdhënien e punës në AUV, si dhe ditët e pushimit vjetor, për praktikë profesionale, për angazhimin me punë praktike me pagesë në AUV, mbi masën disiplinore; Janë paraqitur të dhënat e kërkuara në tabelën e formatit Excel për Pasqyrat vjetore financiare 2024 (Detajet e raportit të numrit të të punësuarve); Janë deklaruar dhe aprovuar të dhënat e kërkuara në formularë të Bankave Komerciale (siç janë: Ndalesat Administrative, Pengu mbi Pagën, etj.), për nëpunës; Aprovimi i kërkesave për Udhëtim Zyrtar jashtë vendit, etj.;

22. Hartimi i shkresave përcjellëse, Akt Emerimeve, Kërkesave, etj.;

23. Përmbledhja e aktiviteteve të punëve të realizuara. Hartimi dhe procedimi i raporteve të punës, si dhe

24. Punë të tjera administrative (njoftime/takime, kërkesa, nëpërmjet e-mail-it/telefonit. Përditësimi i kopjeve të dokumenteve në dosjet fizike, ofrimi i dokumenteve nga dosjet përkatëse të kërkuara nga nëpunësit, etj).

5. ZYRTARI ÇERTIFIKUES

DATA E RAPORTIMIT	LËNDË TË PRANUARA/APROVUARA/
JANAR 2025	1,857 Lëndë të Aprovuara gjatë vitit 2024

6. SEKTORI I PROKURIMIT

Gjatë vitit 2024, Zyra e Prokurimit ka pranuar gjithsej 57 kërkesa për inicim të procedurave të prokurimit. Nga këto, janë përfunduar dhe janë nënshkruar 44 kontrata, 10 procedura janë në proces dhe 3 janë anuluar.

Procedurat e realizuara sipas vlerave dhe llojit përfshijnë:

- 10 procedura me vlerë të madhe (të gjitha të hapura),
- 14 procedura me vlerë të mesme (të gjitha të hapura),
- 8 procedura me vlerë të vogël (4 të hapura dhe 4 të kufizuara),
- 19 procedura me vlerë minimale.

Janë trajtuar 4 ankesa në OSHP, ku 3 janë zgjidhur dhe 1 është ende në proces. Gjithashtu, zyra ka përgatitur planifikimin paraprak dhe përfundimtar të prokurimit për vitin 2025, duke e dorëzuar atë në afatet ligjore në AQP.

Një sfidë kryesore ka qenë mungesa e stafit, pasi zyra ka funksionuar vetëm me një zyrtar të prokurimit, i cili ka kryer të gjitha detyrat dhe ka asistuar MBPZHR-në në përgatitjen e procedurave të prokurimit. Kërkohej shtimi i një zyrtari tjetër të certifikuar dhe me përvojë pune për të lehtësuar ngarkesën.

Gjatë vitit, zyra ka trajtuar me sukses periudhat audituese, duke mos pasur gjetje në raportet e auditorëve të brendshëm dhe të jashtëm. Megjithatë, disa aktivitete të planifikuara nuk janë realizuar për shkak të mangësive në planifikimin nga njësitë kërkuuese. Gjithashtu, janë trajtuar dhe publikuar rreth 15 aktivitete të paplanifikuara pas miratimit nga AQP.

DREJTORIA E INSPEKTORATIT

Raporti Vjetor i Punës për Drejtorin e Inspektoratit gjatë vitit 2024 pasqyron veprimtarinë dhe aktivitetet e realizuara nga Inspektorati në kuadër të Agjencisë së Ushqimit dhe Veterinarisë (AUV)Si autoritet kompetent në Republikën e Kosovës, DI është angazhuar në garantimin e sigurisë ushqimore, ruajtjen e shëndetit publik, mirëqenien e kafshëve dhe shëndetin e bimëve, duke zbatuar detyrat dhe përgjegjësitë e veta ligjore.

Niveli menaxherial dhe profesional ka përmbushur detyrat që lidhen me organizimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e punëve në kuadër të DI. Aktivitetet kryesore kanë përfshirë inspektime, monitorime, audite dhe marrjen e mostrave sipas planeve për kontrollet zyrtare. Këto aktivitete

janë zhvilluar tek operatorët ekonomikë dhe institucionet juridike që kryejnë veprimtari nënshtuar kontrollit zyrtar në çështje veterinarë dhe fitosanitare, si brenda vendit ashtu edhe në pikat kufitare. DI ka mbikëqyrur zbatimin e legjislacionit, duke ndjekur planet vjetore të kontrollit dhe duke realizuar kontrole të rastësishme bazuar në ankesat e konsumatorëve. Për shkak të numrit të kufizuar të inspektorëve, inspektimet janë prioritarizuar sipas rrezikut, duke u bazuar në udhëzuesit për inspektime të bazuara në vlerësimin e rrezikut.

Raporti reflekton përkushtimin e DI-së për përmbushjen e misionit të tij në garantimin e standardeve më të larta të sigurisë dhe mirëqenies për qytetarët.

Tabela 1 Numri i përgjithshëm vjetor i inspektimeve dhe mostrave gjatë vitit 2024

NUMRI I INSPEKTIMEVE DHE MOSTRAVE			
	Vendore	Importit	Totali
Inspektime	10,647	60,303	70,950
Mostra	1,722	40,800	42,522
Totali	12,369	101,103	

Burimi: Dejtorja e Inspektoratit, AUV

1. SEKTORI I BRENDSSHËM VETERINAR DHE FITOSANITAR

1.1.KONTROLI I BRENDSSHËM VETERINAR

Gjatë vitit 2024, Sektori i Inspektoratit Veterinar realizoi aktivitetet sipas Planeve të Kontroleve Zyrtare dhe monitorimit. Kontrollët u fokusuan te operatorët e biznesit me ushqim të miratuar nga AUV, duke përfshirë:

- Objekte për therje kafshësh
- Përpunues të produkteve shtazore (mish, qumësht, peshk, vezë)

- Objekte për ruajtjen e ushqimit

Po ashtu i janë nënshtruar kontrollit zyrtar veterinar edhe fermat e përzgjedhura për monitorimin e Identifikimit dhe Regjistrimit, monitorimi i programeve të vaksinimit dhe hulumtimeve diagnostike, inspektimit në subjektet që merren me shërbimet veterinare, grumbulluesit dhe tregtuesit e lëkurave, si dhe një sërë aktiviteteve të ndryshme dhe sipas kërkesave të institucioneve ligj zbatuese (PK, DK dhe ATK).

Inspektorati Veterinar i brendshëm gjatë vitit 2024, ka realizuar aktivitete si ne vijim:

- Janë kryer aktivitete për parandalimin, kontrollin dhe çrrënjosjen e sëmundjeve infektive të kafshët, duke përfshirë inspektimin e 1,645 fermave blegtorale të gjedhit, fermave të shpezëve dhe bletishteve.
- Janë kryer inspektime dhe monitorime në 127 ambulanca veterinare të kontraktuara, ku është vlerësuar procesi i identifikimit dhe regjistrimit të kafshëve, si dhe testimet diagnostike për sëmundje si TBC. Gjithashtu, është kontrolluar marrja e mostrave dhe testimi i kafshëve të rezultuara pozitive me sëmundje infektive, përfshirë edhe rastet e sëmundjeve në bletishte. Në kuadër të këtij procesi, janë monitoruar gjithsej 896 ferma blegtorale lidhur me identifikimin e kafshëve dhe ofrimin e shërbimeve sipas kontratës me AUV.
- Bazuar në inspektimet dhe monitorimet e fermave, janë asgjësuar gjithsej 260 krerë gjedh, prej të cilëve 159 të prekur nga Bruceloza dhe 101 nga TBC. Po ashtu, janë asgjësuar 417 dele dhe dhi të infektuara me Brucelozë. Nga testimet laboratorike në LUV, janë asgjësuar 631 shoqëri bletësh për shkak të sëmundjes Pesta Amerikane.

Tabela 2. Plani i kontrolleve zyrtare nga inspektorati veterinar i brendshëm

PLANI I KONTROLLEVE ZYRTARE			
KONTROLLE ZYRTARE		INSPEKTIME	
Fabrika të përpunimit të mishit	143	Markete	324
Fabrika të përpunimit të qumështit	106	Mishtore	90
Depo ftohëse për ruajtjen e produkteve me origjinë shtazore	87	Thertore	3,328
Gjithsej	336	Gjithsej	3,742

Burimi: Inspektorati veterinar i brendshëm

Nga aktivitetet tjera kemi bërë kontrollin e gjendjes shëndetësore të kafshëve para therjes, monitorimin e procesit të therjes si dhe kontrollin dhe vulosjen e mishit për lejimin e tij për konsum publik, ku gjithsej janë kontrolluar 37,584 krerë gjedhe.

Tabela 3 Mostrat e dorëzuara në LUV

MOSTRAT E DORËZUARA NË LUV	
Parametra mikrobiologjik	312
Parametra fizo-kimik	89
Mostra për detektim të mbetjeve në ushqim	340
Gjithsej	741

Burimi: Inspektorati veterinar i brendshëm

ASGJËSIMI I PRODUKTEVE (KG)	
Produkte mishi	522,955
Produkte qumështi	226,981
Mjaltë	474
Peshk	40,506
Total	790,916

Gjatë kësaj periudhe, inspektorët veterinarë kanë kryer kontrole dhe çertifikime për eksportin e 1,919 ngarkesave, si më poshtë:

- 153 ngarkesa për eksport të lëkurave të gjedhit, me një sasi totale prej 2,560,121.81 kg.
- 785 ngarkesa për eksport dhe riekport të produkteve të mishit, me një sasi prej 374,626,691.89 kg.
- 171 ngarkesa për eksport të qumështit tetrapak, në sasi prej 2,654,287.65 kg.
- 348 ngarkesa për eksport të produkteve të qumështit, në sasi prej 2,381,617.1 kg.
- 53 ngarkesa për eksport të peshkut të gjallë dhe të ngrirë, në sasi prej 68,050 kg.
- 243 ngarkesa për riekport të kafshëve të gjalla për therje, me një total prej 10,771 krerësh gjedh.
